



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**

*Sesioni vjeshtor*

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Mbledhja nr. 59**

**Prishtinë, më 21.11.2024, në orën 9:10**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303**

**PROCESVERBAL**

**Morën pjesë:** Hydajet Hyseni- Kaloshi dhe Bahrim Shabani, zëvendëskryetarë, Arijeta Rexhepi, Milazim Salijaj, Valentina Bunjaku- Rexhepi, Shemsedin Dreshaj, Enis Kervan, Fridon Lala dhe Bekim Arifi, anëtarë.

**Munguan:** Elmi Reçica, Adem Hoxha dhe Fadil Gashi, anëtarë.

**Të pranishëm të tjerë:** Hysni Mehani, asistent i GP LVV dhe Celal Iliaz, përfaqësues i Drejtorisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Drita Çarkaxhiu.

**Mbledhjen e kryesoi:** Hydajet Hyseni- Kaloshi, zëvendëskryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura me 14.11.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-304 për Bankat, me raport amandamente të Komisionit funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-279 për Inspektoratin qendror të mbikëqyrjes së tregut, me raport amandamente të Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti;
5. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura me 14.11.2024.**

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me 14.11.2024, miratohet pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-304 për Bankat, me raport amandamente të Komisionit funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere.**

**Zëvendëskryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjit nr.08/L-304 për Bankat me amendamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

**Shemsedin Dreshaj**, deklaroi se prezenca e tij nuk do të krijojë kuorum në komision.

Meqë nuk pati diskutim, zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

### **Rekomandim**

Projektligji nr.08/L-304 për Bankat, me amendamente të Komisionit funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

## **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-279 për Inspektoratin qendror të mbikëqyrjes së tregut, me raport amandamente të Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti.**

**Zëvendëskryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-279 për Inspektoratin qendror të mbikëqyrjes së tregut, me amendamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Meqë nuk pati diskutim, zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

### **Rekomandim**

Projektligji nr.08/L-279 për Inspektoratin qendror të mbikëqyrjes së tregut, me amendamente të Komisionit funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

Mbledhja përfundoi në orën 9:30.

E përgatiti: Staf i mbështetës i Komisionit.

**Hydajet Hyseni- Kaloshi,**

---

**Zëvendëskryetar i Komisionit**